



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.200/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Hasan Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,000.00 (tremijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 12.10.2017, me të cilën pretendon se Kandidati për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik AKR, Selim Pacolli në spotin e tij publicitar, ka përdorur asetet e Kompanisë Pastrimi e që janë asete të ndërmarrjes publike. Parashtruesi i ankesës më tej thekson se kjo bie ndesh me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe me Rregullat Zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një CD, me propozim për Panelin që ankesa të pranohet në tërësi si e bazuar.

Subjekti politik AKR, në përgjigjen në ankesë të datës 13.10.2017, theksoi se ankesa e bërë ndaj tyre nuk qëndron pasi që kandidati për kryetar të Komunës Selim Pacolli në spotin publicitar ku ka përdorur mjetin e kompanisë së pastrimit “Pastrimi”, në asnjë moment nuk ka përdorur slogane të partisë AKR apo numrin zgjedhorë, që e identifikon subjektin.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Selim Pacolli, kandidat për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik AKR, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, kandidati në fjalë ka bërë fushatë duke përdorur asetet e kompanisë publike, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 të LZP-së.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.


Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Aleanca Kosova e Re - AKR, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigje nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar dhe kanë theksuar se kandidati për kryetar të Komunës Selim Pacolli në spotin publicitar ku ka përdorur mjetin e kompanisë së pastrimit “Pastrimi”, në asnjë moment nuk ka përdorur slogane të partisë AKR-së apo numrin zgjedhorë, që e identifikon subjektin. Rrethana këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi se dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikoj që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Zl.Anr.200/2017 me datën 16.10.2017

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par4 të LZP-së.

